



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 480/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e dates 29.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfyqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik “Ina” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur” me Nr.REF-65806-07-16-2020, me objekt: “*Rikonstruksionin e Pediatriisë Infektive në QSUT*”, me fond limit 34,187,187 pa TVSH, zhvilluar me date 24.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
- Ankimues:** “Kevin Konstruksion” sh.p.k
Rr. “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Nj.B nr.5, Tirane
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë
- Subjekte të Interesuar:** “Ina” sh.p.k
Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedure e Hapur” me Nr.REF-65806-07-16-2020, me objekt: “*Rikonstruksionin e Pediatrikë Infektive në QSUT*”, me fond limit 34,187,187 pa TVSH, zhvilluar me date 24.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

II.2. Në datën 15.09.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

1. “Eurondertimi 2000” sh.p.k	17.730.486 lekë, skualifikuar
2. “Ina” sh.p.k	18.804.482 lekë, kualifikuar
3. “Liqeni VII” & “Kupa” sh.p.k	19.960.302 lekë, skualifikuar
4. “Kevin Konstruksion” sh.p.k	22.199.071 lekë, kualifikuar
5. “Rafin Company” sh.p.k	24.945.729,5 lekë, skualifikuar
6. “R&T” sh.p.k	25.383.232,8 lekë, kualifikuar
7. “S.A.G” dhe “Kronos Konstruksion” sh.p.k	26.065.786 lekë, skualifikuar
8. “Colombo” sh.p.k	26.203.169 lekë, skualifikuar

9. “Be-Is” sh.p.k	26.945.596 lekë, kualifikuar
10. “Jogi” & “Real Construction Company” sh.p.k	26.956.815 lekë, skualifikuar
11. “Kacdedja” sh.p.k	27.267.225 lekë, kualifikuar
12. “Leon Konstruksion” sh.p.k	29.400.039,8 lekë, kualifikuar
13. “Elda-VI” sh.p.k	s’ka paraqitur ofertë
14. “Midea Albania” sh.p.k	s’ka paraqitur ofertë

II.3 Në datën 21.09.2020, operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e ofertes së subjektit “Ina” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...]”

1. *Kundershtojme kualifikimin e ofertes së operatorit ekonomik Ina Sh.p.k ne kete procedure prokurimi.*

Njësia e prokurimit ka kërkuar:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka punësuar ne stafin e vete punonjes me profesioneve si më poshte:

- 1 teknik ndertimi*
- 3 punonjes elektrikist*
- 1 punonjes hidraulik*
- 1 punonjes saldator*
- 4 punonjes mekanik*
- 1 punonjes bojxhi*
- 1 punonjes pllakashtrues*
- 1 muratore*
- 1 hidroizolues*

Kodet e profesioneve te listepagave sanksionohen nga V.K.M nr 514, date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) te rishikuar.

<i>1 teknik ndertimi</i>	<i>3112.06</i>
<i>3 punonjes elektrikist</i>	<i>7411.01</i>
<i>1 punonjes hidraulik</i>	<i>7126.03</i>
<i>1 punonjes saldator</i>	<i>7212.09</i>
<i>4 punonjes mekanik</i>	<i>7421</i>
<i>1 punonjes bojxhi</i>	<i>7131.07</i>
<i>1 punonjes pllakashtrues</i>	<i>7122</i>
<i>1 muratore</i>	<i>7112.05</i>
<i>1 hidroizolues</i>	<i>7124.07</i>

Këto kode sanksionohen nga vendimi i Këshillit të Ministrave, jo prej jush.

Në dijenine tone OE “Ina” Shpk nuk ploteson kriterin e mësipërm të vendosur nga Njësia e Prokurimit, për shkak se teknikat e operatorit ekonomik Ina sh.p.k nuk janë paraqitur me kodet respektive të lartpërmendura ne listëpagesat. Paraqitja e dokumentave të pasakta përbën shkak për skualifikim.

Kërkojmë që Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të verifikojë kodet e profesioneve të teknikeve të mesëm në listëpagesa dhe të disponojë me vendim duke skualifikuar operatorin ekonomik “Ina” sh.p.k.

Në DST njësia e prokurimit ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të ketë mjetet dhe pajisjet si më poshte:

Emri i Mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
Autovinc	copë	1	Në pronesi ose me qira

OE “Ina” shpk nuk ka plotësuar këtë kriter ekonomik të vendosur nga njësia e prokurimit. Në dijeninë tonë mjeti i paraqitur për autovinc, në të vërtetë është një kamion i pajisur me vinc të vogël.

Në dokumentat e tenderit njësia e prokurimit ka kërkuar dokumentacionin: certifikata e pronesisë; Leja e qarkullimit; Certifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses për taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese. Njësia e prokurimit nuk ka kërkuar kamionin me vinc, por ka kërkuar autovinc.

Autovinci është një platforme vetëvizuese ngritëse me vinc, e ngarkuar mbi një shasi. Kjo platforme ka emërtimin “autovinc” në certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, kolaudimi siguracioni dhe taksat vjetore. Në dijeninë tonë në dokumentacionin e mjetit Certifikata e pronesisë; Leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses për taksat vjetore; siguracionin që ka paraqitur Ina shpk, mjeti figuron KAMION, sic është në të vërtetë.

Nga kjo konfirmojmë që operatorin ekonomik Ina shpk, nuk plotëson kriterin e kërkuar në DT nga njësia e prokurimit, fakt që përbën shkak për skualifikimin.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 2894 /2 prot., datë 25.09.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“[...] .”

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga “Kevin Konstruksion” Shpk, konstatojmë se :

Në lidhje me pretendimin numer 1 (2.3.10) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin vetëpunonjës me profesionet si më poshte :

1 teknik ndertimi

3 punonjës elektrikist

1 punonjës hidraulik

1 punonjës saldator

4 punonjës mekanik

1 punonjës bojaxhi

1 punonjës pllakashtrues

1 muratore

1 hidroizolues

Për punonjësit e mesiperm, operatorin ekonomik duhet të paraqesë: Kartelat personale të sigurimit teknik të leshuara nga një organ i akredituar certifikues (Grup certifikues) në bazë të Ligjit nr 8734 datë 01.02.2001 “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve të Instalimeve Elektirke”, i ndryshuar, dhe të VKM nr 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të

subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar. Per punonjesit teknik ndertimi duhet te paraqitet dokumenti qe verteton kualifikimin (Deftese dhe/ose Diplome).

Te gjithe punonjesit e kerkuar me siper duhet te paraqese kontratën individuale te punes si dhe te figurojne ne listpagesat per periudhen Janar2020-Qeshor2020.

Për sa i perket pretendimit te OE “Kevin Konstruksion” Shpk ne lidhje me Kodet e listepagesave të cilat sanksionohen në VKM 514, date 20.09.2017 “Për miratimin e listës Kombetare te profesioneve (LKP) te rishikuar, Operatori Ekonomik Ina Shpk tekniket nuk i ka paraqitur me kodet respektive në listëpagesë sipas VKM të lartëpërendur dhe kjo perben shkak per skualifikim. Persa me siper ky pretendim o Operatorit Ekonomik “Kevin Konstruksion” Shpk nuk qendron pasi bazuar ne dst e lartepemendur eshte kerkuar shprehimisht si kriter i vecant ne piken 2.310 se ...: Per punonjesit e mesiperm, operatori ekonomik duhet te paraqesi: kartelat personale te sigurimit teknik te leshuara nga nje organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues) ne baze te Ligjit nr. 8734 date 01.02.2001 "Per Garantimin e Sigurise se Punes te Pajisjeve te Instalimeve Elektrike", i ndryshuar dhe te VKM nr.42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar...

Nga Verifikimi i dokumentave të tenderit te Operatorit Ekonomik INA shpk rezulton se ky operator ploteson kriterin sipas pikes 2.3.10.

Në DST nuk eshte kerkuar si kriter plotesimi i punonjesve me Kodet e listepagesave të cilat sanksionohen ne VKM 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes Kombetare te peofesioneve (LKP) të rishikuar. Në rast se operatori ekonomik ankumues do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mesipërme persa i përket kodeve te listëpagesave, ka patur ne dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumentave dhe kriterëve te vecanta të kualifikimit te procedurës së prokurimit objekt, ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Ne nenin 63 pika të ligjit nr 9643 date 20.11.2006 “per Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjishtashtu kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomike të cilët kanë paqartësi në lidhje e interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktore dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankumues do të kishte paqartësi ne lidhje mbi plotesimin e kerkeses së mësipërme, ka ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes së kërkesës për sqarje pranë autoritetit kontraktor dri ne pesë dite para dorezimit te ofertave parsshikuar nga neni 42 i LPP-së. Ne nenin 42 pika 1 te ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuarparashikohet se : “[...]Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që

të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [..]

Nga sa më sipër pretendimi i Operatorit Ekonomik "Kevin Konstruksion" shpk nuk qëndron.

Shqyrtimi i ankeses nr 2 nga Operatori Ekonomik .

Në zbatim të dispozitave ligjore e parashikuara ne ligjin 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar VKM nr 914, date 29.12.2014 " për miratimin e rregullve te prokurimit publik" i ndryshuar, DST-së, si dhe dispozitave ligjore dhe nenligjore në luqi, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses (KSHA) konstaton se në DST janë kerkuar:

2.3.11 Operatori ekonomik duhet e kete mjetet dhe pajisjet si me poshte

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
4	Autovinc	copë	1	Në pronesi ose me qira

Për automjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet e paraqitet dokumentacioni që vërteton proësinë e mjetit: Certifikata e pronesise; leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatase; ndersa per automjetet e marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm duhet te paraqitet kontrata e qerase (vlefshmeria e te ciles duhet te mbuloje kohezgjatjen e kontrates).

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga Operatori Ekonomik Ina sh.p.k rezulton se ka plotesuar kriterin 2.3.11 per mjetin autovinc duke paraqitur dhe dokumentat: Certifikata e pronesise; leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatse; si dhe kontrata e qerase (vlefshmeria e te ciles duhet te mbuloje kohezgjatjen e kontrates).

Gjithashtu KSHA nga verifikimi i dokumentacionit te depozituar nga ana juaj rezulton se pika 2.3.11 per mjetin autovinc eshte plotesuar me te gjitha kriteret e kerkuara.

-Ne lidhje me pretendimin e OE "Kevin Konstruksion" shpk se kamioni i OE Ina Shpk eshte i pajisur me vinc te vogel, KSHA konstaton se ne DST nuk ka specifika te vecanta lidhur me autovincin.

-Ne lidhje me pretendimin e OE "Kevin Konstruksion" shpk se njesia e prokurimit nuk ka kerkuar kamion me vinc, por ka kerkuar autovinc, duke pretenduar se Autovinci eshte nje platforme vetëlevizëse ngritese me vinc, e ngarkuar mbi nje shasi. Kjo platforme ka emertimin "Autovinc" ne certifikaten e pronesise, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, vertetimi i pageses per taksat vjetore, siguracionin qe ka paraqitur Ina Shpk, mjeti figuron me emrin Kamion sic eshte ne të vërtetë.

Nga verifikimi i dokumentave të tenderit për të dy operatorët ekonomik në lidhje me kete kriter, KSHA ka konstatuar se ky kriter eshte plotësuar nga të 2 operatorët. Kjo verifikohet në certifikaten e pronësisë dhe ne lejen e qarkullimit ku rezulton se te dy operatorët kane paraqitur dokumentacionin per mjetin autovinc e kerkuar "Kamion me vinc". Sa me siper, KVO ka vlerësuar se ky kriter i kerkuar ne DST është plotësuar nga te 2 Operatorët.

Pas shqyrtimit te ankeses AK vendos:

Te mos pranojë pretendimet e ngritura nga OE "Kevin Konstruksion" shpk në ankesen e administruar pranë AK QSU "NËNË TEREZA" si te pabazuara ne ligj dhe ne prova, duke lenë në fuqi vendimin e KVO-së .

II.5. Në datën 28.09.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar:

Njësia e prokurimit ka kërkuar:

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të deshmojë se ka punësuar në stafin e vetë punonjës me profesionet si më poshtë:

*1 teknik ndertimi
3 punonjës elektrikist
1 punonjës hidraulik
1 punonjës saldator
4 punonjës mekanik
1 punonjës bojaxhi
1 punonjës pllakashtrues
1 muratore
1 hidroizolues*

Kodet e profesioneve të listepagave sanksionohen nga V.K.M nr 514, date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar.

<i>1 teknik ndertimi</i>	<i>3112.06</i>
<i>3 punonjës elektrikist</i>	<i>7411.01</i>
<i>1 punonjës hidraulik</i>	<i>7126.03</i>
<i>1 punonjës saldator</i>	<i>7212.09</i>
<i>4 punonjës mekanik</i>	<i>7421</i>
<i>1 punonjës bojaxhi</i>	<i>7131.07</i>
<i>1 punonjës pllakashtrues</i>	<i>7122</i>
<i>1 muratore</i>	<i>7112.05</i>
<i>1 hidroizolues</i>	<i>7124.07</i>

Ne ankesën e paraqitur prej nesh kemi arsyetuar se paraqitja e profesioneve me kodet e lartpërmendura sanksionohen nga vendimi i keshillit të ministrave, jo prej nesh.

Ne dijeninë tonë Operatori Ekonomik INA shpk nuk plotëson kriterin e mesipër të vendosur nga Njësia e Prokurimit, për shkak se punonjësit e operatorit ekonomik INA sh.p.k. nuk janë të paraqitur me kodet respektive të lartpërmendura në listepagesat. Paraqitja e dokumentave të pa sakta përben shkak për skualifikim.

Pajisja me kartelat e sigurimit teknik nuk verteton që punonjësit e pajisur me këto kartela të kenë profesionin apo kualifikimin e përmendur në kartele.

Njohuritë për një profesion të caktuar nuk merren nga trajnimi për rregullat e përdorimit të pajisjeve elektrike.

Programi i trajnimit dhe i testimit për të marrë kartelën (kategorinë) e sigurimit teknik është i njëjte për të gjitha profesionet. Sidomos kur bëhet fjalë për kategorinë e parë dhe të dytë të sigurimit teknik.

Programi i trajnimit dhe i testimit bën fjalë për përdorimin e pajisjeve elektrike dhe pasqyrohet në kartelën e sigurimit teknik të përdorimit të pajisjeve elektrike - që përbehet nga: Rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impjantet pajisjet dhe instalimet

elektrike, ligji nr. 8734, date 01.02.2001 "Per garantimin e sigurise se punes se pajisjeve elektrike", ligji nr. 13/2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne igjin nr. 8734 date 01.02.2001.

Te gjitha kartelat e sigurimit teknik e kane te njejte kete program trajnimi qe permendem me lart, pavaresisht profesionit te personave te trajnuar.

Kartelat e sigurimit teknik te perdorimit te pajisjeve elektrike nuk jane prove shkresore e trajnimit per tu kualifikuar ne nje profesion te caktuar.

Trajnimi per te perfituar nje profesion te caktuar merret duke marre pjese ne kurse trajnimi dhe kualifikimi per fushat specifike ne cdo profesion te caktuar.

Ne praktike kur behen trajnimet dhe testimet per sigurimin teknik te gjitha profesionet se bashku bejne trajnim ne te njejten dite per te perfituar kartelen e sigurimit teknik te perdorimit te pajisjeve elektrike. Gjate trajnimit ata kane te njejtin program. Po keshtu gjate testimet ata kane te njejten teze.

Dokumenti zyrtar provues i pranuar gjeresisht se pari nga organet tatimore, eshte listepagesa e cila sjell detyrime finaciare per subjektin dhe te drejta financiare per punemarresin. Ne kete listepagese pasqyrohen te dhenat personale te te punesuarit dhe ne kete listepagese pasqyrohet edhe emri edhe mbiemri i nepunesit qe ka bere deklarimin.

Neqoftese keto deklarime jane te rreme lidhur me kodet e profesioneve ne listepagesa, atehere eshte plotesuar nje kusht i rendesishem per skualifikim.

Neqoftese kodet ne listepagesat e "INA" shpk, nuk perputhen me profesionet e pasqyruara ne IQT, atehere njeri nga keto dokumenta eshte me te dhena te rreme.

Neqoftese listepagesa eshte me te dhena te pa sakta ne pjesen pershkruese te profesioneve te punonjesve eshte plotesuar kushti ne d.s.t: "Rastet e paraqitjes se dokumentave te rreme ose te pasakta perbejne kusht per skualifikim".

Neqoftese profesioni i paraqitur ne IQT me te dhena te pa sakta, dhe ne te njejten kohe informacioni mbi profesionin e punonjesve ne listepagesa eshte i sakte, atehere ndodhemi para te njejtit kriter skualifikimi te plotesuar.

D.s.t nuk paraqet llojet e dokumentave qe mund ti paraqesesh te pasakta dhe te mos skualifikohesh.

D.s.t. thote shkurt: rastet e paraqitjes se dokumentave te rreme ose te pa sakta do te konsiderohen si kusht per skualifikim.

Lidhur me pretendimin e Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave, sipas se cilit njesia e prokurimit nuk ka kerkuar kodet e listepagesave sipas profesioneve, ju bejme me dije se: Autoriteti Kontraktor dhe Njesia e Prokurimit kane kerkuar "Listepagesat". Kjo do te thote se i kane kerkuar te gjitha listepagesat, me te gjitha elementet perberes, ku perfshihet edhe profesioni i punonjesve qe shprehet me kodin perkates ne zbatim te vendimit te keshillit te ministrave nr. 514 date 20.9.2017 "Per miratimin e listes kombetare te profesioneve".

Administrimi i listepagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, K.V.O dhe Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave do te thote se keta persona kane ne dispozicion nje informacion te detajuar mbi kompanine qe ka konkurruar.

Ky informacion i detajuar shtrihet mbi numrat personale te sigurimeve shoqerore te punonjesve, mbi pagat qe ata marrin dhe mbi profesionin apo pozicionin e tyre ne kompani.

Administrimi i ketij informacioni behet duke kryqezuar te dhenat nga dokumentat e tjera te kerkuara nga Njesia e Prokurimit. Neqoftese Njesia e Prokurimit ka kerkuar listepagesat, do te thote qe automatikisht ka kerkuar informacion te detajuar mbi burimet njerezore te kompanise. Dhe per me teper Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave nuk mund te beje sikur nuk e shikon.

Ne momentin qe Njesia e Prokurimit ka kerkuar listepagesat, atehere ka kerkuar qe edhe kodet e profesioneve te perputhen me realitetin.

Ne raste te ngjashme, nje autoritet tjeter kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka kerkuar vetem vertetim numri punonjesish nga organet tatimore per efekt te pageses se sigurimeve shoqerore. Dhe nuk ka kerkuar listepagesa.

Ne rastin tone Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza", ka kerkuar listepagesat me emer dhe mbiemer te punonjesve, numrin personal te tyre dhe profesionin perkates apo pozicion ne kompani. Po keshtu ka kerkuar pagat e secilit ne kompani dhe shumat qe u mbahen per efekt te pagesave te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Ne momentin qe autoriteti kontraktor ka kerkuar listepagesat, ka te dreiten dhe detyren per te verifikuar vertetesine e listepagesave. Vertetesia e listepagesave verifikohet per te giithe elementet nga fillimi ne fund. Ky proces nuk behet pjeserisht po, pjeserisht jo dhe pjeserisht ndoshta.

Kerkojme ndryshimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave dhe Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave, duke skualifikuar operatorin INA shpk.

Në DST njësia e prokurimit ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te kete mjetet dhe pajisjet si me poshte:

Emri i Mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
Autovinc	copë	1	Në pronesi ose me qira

Operatori ekonomik INA shpk nuk e ka plotesuar kete kriter ekonomik te vendosur nga Njesia e Prokurimit. Ne dijenine tone mjeti i paraqitur per autovinc, ne te vertete eshte nje kamion i pajisur me vinc te vogel. Ne d.s.t Njesia e Prokurimit ka kerkuar dokumentacionin certifikata e pronesise; leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese.

Njesia e prokurimit e Q.S.U.T. nuk ka kerkuar kamion me vinc, por ka kerkuar autovinc. Autovinci eshte nje platforme vetelevizese ngritese me vinc, e ngarkuar mbi nje shasi.

Kjo platforme ka emertimin "autovinc" - APV, ne certifikaten e pronesise, lejen e qarkullimit, kolaudimi, siguracioni, dhe taksat vjetore. Ne dijenine tone ne dokumentacionin e mjetit certifikata e pronesise; leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; vertetimi i pageses per taksat vjetore; siguracionin qe ka paraqitur INA shpk, mjeti figuron me emertimin kamion, sic eshte ne te vertete. Nga kjo konfirmojme qe operatori ekonomik INA shpk, nuk ploteson kriterin e kerkuar ne d.s.t. nga Njesia e Prokurimit, fakt qe perben shkak per skualifikim.

Kthimi i pergjigjes le te kuptohet se Komisioni i Shqyrtimit te Ofertave ka verifikuar dokumentacionin e automjetit me qira te operatorit ekonomik INA sh.p.k.

Ne dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik INA sh.p.k lihet te kuptohet se ne certifikaten e pronesise se automjetit, lejen e qarkullimit siguracionin, kolaudimin dhe taksat vjetore figuron vetem fjala kamion. Nuk figuron fjala autovinc, sic ka kerkuar Njesia e

Prokurimit e Autoritetit Kontraktor Q.S.U.T. Emertimi orgjinal i autovincit anglisht eshte - "autocrane" - (emertimi i prodhuesve të autovincave). Autovinci nuk kryen funksionet e kamionit. Eshte ekskluzivisht plafforme me vinc. Njesia e prokurimit nuk ka kerkuar kamion me vinc, por ka kerkuar ekskluzivisht autovinc (ka kerkuar autovinc dhe asgje tjeter). Ne certifikaten e pronesise dhe ne lejen e qarkullimit keta lloj mjetesh ne rubriken lloji destinacioni dhe perdorimi - paraqiten me termin APV (automjet per pedorim te vecante). Nuk paraqiten me termin kamion me vinc. Per ilustrim po ju paraqesim ilustrim nje certifikate pronesie dhe nje leje qarkullimi te nje autovinci. Po keshtu edhe nje fotografi [...].”

II.6. Në datën 09.10.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr 1183/2 prot, shkresa e autoritetit kontraktor nr 3010/2 prot., datë 07.10.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Kevin Konstruksion” shpk se: “Njësia e prokurimit ka kërkuar: “2.3.10 Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka punësuar ne stafin e vete punonjese profesioneve si më poshte: 1 teknik ndertimi; 3 punonjes elektrikist; 1 punonjes hidraulik; 1 punonjes saldator; 4 punonjes mekanik; 1 punonjes bojaxhi; 1 punonjes pllakashtrues; 1 muratore; 1 hidroizolues”. Kodet e profesioneve te listepagave sanksionohen nga V.K.M nr 514, date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) te rishikuar. 1 teknik ndertimi -3112.06; 3 punonjes elektrikist - 7411.01; 1 punonjes hidraulik - 7126.03; 1 punonjes saldator - 7212.09; 4 punonjes mekanik – 7421; 1 punonjes bojaxhi- 7131.07; 1 punonjes pllakashtrues -7122; 1 muratore- 7112.05; 1 hidroizolues- 7124.07. Këto kode sanksionohen nga vendimi i Këshillit te Ministrave. Në dijenine tone OE “Ina” Shpk nuk ploteson kriterin e mësipërm të vendosur nga Njësia e Prokurimit, për shkak se tekniket e operatorit ekonomik Ina sh.p.k nuk janë paraqitur me kodet respektive të lartpërmendura ne listëpgesat. Paraqitja e dokumentave të pasakta përbën shkak për skualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.10 ”Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar ne stafin e vete punonjes me profesioneve si me poshte:

1 (nje) teknik ndertimi

3 (tre) punonjes elektrikist

1(nje) punonjes hidraulik

1(nje) punonjes saldator

4 (kater) punonjes mekanik

1 (nje) punonjes bojaxhi

1 (nje) punonjes pllakashtrues

1 (nje) muratore

1 (nje) hidroizolues

Per punonjesit e mesiperm, operatori ekonomik duhet te paraqesi: kartelat personale te sigurimit teknik te leshuara nga nje organ i akredituar certifikues personeli (Grup Certifikues) ne baze te Ligjit nr. 8734 date 01.02.2001 "Per Garantimin e Sigurise se Punes te Pajisjeve te Instalimeve Elektrike", i ndryshuar dhe te VKM nr.42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar. Per punonjesit teknik ndertimi duhet te paraqitet dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome). Te gjitha punonjesit e kerkuar me siper duhet te paraqese kontratën individuale të punës si dhe te figurojne ne listepagesat per periudhen Janar 2020-Qershor 2020.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes "Ina" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër, përta i përket kërkesës për 3 punonjes elektrikist, 1 (nje) punonjes pllakashtrues, 1 (nje) muratore dhe 1 (nje) hidroizolues, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Janar 2020-Korrik 2020.*
- *Kontratë Pune datë 01.05.2020 lidhur ndërmjet punëdhënësit Ina shpk dhe punëmarësit B.Hysa në detyrën "elektracist", Dëshmi Kualifikimi e sigurimit Teknik profesioni "elektracist".*
- *Kontratë Pune datë 01.05.2020 lidhur ndërmjet punëdhënësit Ina shpk dhe punëmarësit F.Gjeci në detyrën "elektracist", Dëshmi Kualifikimi e sigurimit Teknik profesioni "elektracist".*
- *Kontratë Pune datë 01.06.2020 lidhur ndërmjet punëdhënësit Ina shpk dhe punëmarësit L.Gjeci në detyrën "elektracist", Dëshmi Kualifikimi e sigurimit Teknik profesioni "elektracist".*
- *Kontratë Pune datë 01.04.2020 lidhur ndërmjet punëdhënësit Ina shpk dhe punëmarësit E.Meta në detyrën "pllakashtrues", Dëshmi Kualifikimi e sigurimit Teknik profesioni "pllakashtrues/bojaxhi".*
- *Kontratë Pune datë 01.03.2020 lidhur ndërmjet punëdhënësit Ina shpk dhe punëmarësit K.Zacellari në detyrën "Specialist ndertimi murator", Dëshmi Kualifikimi e sigurimit Teknik profesioni "murator".*
- *Kontratë Pune datë 01.05.2020 lidhur ndërmjet punëdhënësit Ina shpk dhe punëmarësit A.Mema në detyrën "Hidroizolues", Dëshmi Kualifikimi e sigurimit Teknik profesioni "Hidroizolues".*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon ”

a licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, parashikohet:

1. Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, e njohur shkurtimisht si “LKP”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.

3. Lista Kombëtare e Profesioneve (LKP) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Kodet statistikore të Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Listën Kombëtare të Profesioneve (LKP), bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Instituti i Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore kryejnë përditësimin e informacionit statistikor zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3, për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

III.1.6. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se operatori ekonomik duhet te kete te punesuar, përvec të tjerëve, minimalisht 3 punonjes elektrikist, 1 (nje) punonjes pllakashtrues, 1 (nje) muratore dhe 1 (nje)

hidroizolues. Per secilin nga keto punonjes duhet te paraqiten kartelat personale te sigurimit teknik te leshuara nga nje organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues), kontrata individuale e punës si dhe është kërkuar te figurojne ne listepagesat (e shoqërisë) per periudhen Janar 2020-Qershor 2020.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Ina” sh.p.k në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit për tre elektrikistë, rezulton se janë paraqitur kontratat e punës dhe dëshmi të sigurimit teknik. Gjithashtu janë dorëzuar listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën e kërkuar nga ku rezulton se punonjësi B.Hysa është deklaruar në listpagesat për periudhën janar-maj 2020 me kodin 7124.03 (Punëtor izolimi për ndërtesa), ndërkohë që referuar VKM nr. 514, datë 20.09.2017, profesioni “elektracist” ka kodin 7411.01. Po kështu F.Gjeci rezulton se në listpagesa është deklaruar me kodin 7131.07 (Bojaxhi) dhe L.Gjeci me kodin 7122.07 (Shtrues pllakash), ndërsa sipas VKM-së së mësipërme profesioni “elektracist” ka kodin 7411.01

Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për një pllakashtrues, rezulton se operatori ekonomik “Ina” sh.p.k ka deklaruar në ofertë punonjës in E.Meta, i cili në listpagesa është deklaruar me kodin 7131.07 (Bojaxhi). Referuar VKM së sipërcituar profesionit “pllakashtrues” i korrespondon kodi 7122.07. Përsa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor për një murator, rezulton se operatori ekonomik “Ina” sh.p.k ka deklaruar në ofertë punonjës in K.Zacellari, i cili në listpagesa është deklaruar me kodin 9624.01 (Punëtor në ujisjellës dhe kanalizime) dhe referuar VKM së sipërcituar profesionit “murator” i korrespondon kodi 7112. Gjithashtu me kodin 7122.07 (Shtrues pllakash) në listpagesa rezulton të jetë deklaruar edhe punonjësi A.Mema të cilin shoqëria “Ina” sh.p.k e ka deklaruar si hidroizolues në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe referuar VKM-së në fjalë, kodi i profesionit “hidroizolues” është 7124.

III.1.8. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ina” nuk mund të konsiderohet i vlefshëm në këtë procedurë prokurimi për 3 punonjes elektrikist, 1 (nje) punonjes pllakashtrues, 1 (nje) murator dhe 1 (nje) hidroizolues.

III.1.9. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi kualifikimin e padrejtë të ofertës së operatorit ekonomik “Ina” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë dhe operatori ekonomik “Ina” sh.p.k nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të jetë e skualifikuar, ndaj shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur” me Nr.REF-65806-07-16-2020, me objekt: “Rikonstruksionin e Pediatriisë Infektive në QSUT”, me fond limit 34,187,187 pa TVSH, zhvilluar me date 24.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Ina” sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1183 Protokoli,

Datë 28.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri